



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova

Komuna e Ferizajt
Opština Urosevac
Municipality of Ferizaj

Shpallja e Përfituesve të Nën-Projekteve për Renovim / Rindërtim të Projektit për Banimin Social Adekuat

Në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar më 23 dhjetor 2024 mes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Komunës së Ferizaj, si dhe bazuar në Thirrjen Publike për shprehje të interesit për nën-projektin: renovimi / rindërtimi i shtëpive private për familjet dhe individët e cenueshëm në kuadër të projektit “Banimi Social Adekuat” të shpallur nga Komuna e Ferizajt, pas përfundimit të procesit të verifikimit të aplikimeve nga Njësi i Implementimit të Projektit (NJIP) dhe vlerësimit nga Komisioni Vlerësues i Komunës, në koordinim me Njësitin e Menaxhimit të Projektit (NjMP) në MMPHI, shpallen rezultatet për përfituesit e nën-projekteve renovimi / rindërtimi i shtëpive private për familjet dhe individët e cenueshëm në kuadër të Projektit “Banimi Social Adekuat”.

Shpallja e përfituesve synon të sigurojë transparencë, barazi dhe paanshmëri në procesin e përzgjedhjes, si dhe të mbështesë implementimin e drejtë të Projektit.

Kriteret e Përzgjedhjes

Me rastin e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve për përfituesit e nën-projekteve për renovim / rindërtim të shtëpive private për familjet dhe individët e cenueshëm, Komisioni Vlerësues i themeluar në kuadër të Komunës ka marrë për bazë kriteret e shpallura në thirrjen publike të datës 29.07.2025 të përmbledhura si në vijim:

- Nevoja e dëshmuar / e verifikuar për renovim / rindërtim të shtëpisë
- Statusi i dëshmuar social i aplikuesit – cenueshmëria
- Pronësia e dëshmuar e parcelës / shtëpisë në emër të aplikuesit
- Leja ndërtimore ose Legalizimi i shtëpisë në rastin e renovimit
- Madhësia adekuate e parcelës për rindërtim

Lista e Aplikuesve - Përfitues të Nën-Projektit “Renovimi/Rindërtimi i shtëpive për familjet dhe individët e cenueshëm”

Nr.	Emri dhe Mbiemri i përfituesit	Nën-projekti
1.	Haxhim Hasani	Rindërtim
2.	Kadengjike Rashiti	Rindërtim
3.	Ardian Zefi	Rindërtim
4.	Hakija Maliqi	Rindërtim
5.	Adem Asllani	Renovim
6.	Naim Bislimi	Renovim
7.	Gzim Jupa	Rindërtim
8.	Zeqir Kryeziu	Rindërtim

2. Lista e pritjes

Në listën e pritjes janë vendosur aplikuesit që gjerë në momentin e shpalljes së rezultateve nuk i kanë plotësuar të gjitha kriteret, por kanë dëshmuar fillimin e procedurave të plotësimit të tyre, sikurse: rregullimi i trashëgimisë pronësore – bartja e pronës në emër të aplikuesit dhe / ose legalizimi në rastin e renovimit.

Aplikuesit në listë të pritjes konsiderohen si përfitues potencial apo të refuzuar varësisht nga plotësimi i kushtit brenda gjashtë (6) muajsh nga data e shpalljes së kësaj liste.

Nr.	Emri dhe Mbiemri i aplikuesit në listë të pritjes	Nën-projekti	Dokumenti i munguar / në proces:
1.	Tafil Murati	Rindërtim	Statusi i Pronësisë (Fleta Poseduse)
2.	Bashkime - Sabrije Ramadani	Renovim	Statusi i Pronësisë (Fleta Poseduse)
3.	Valbona Gashi	Rindërtim	Statusi i Pronësisë (Fleta Poseduse)
4.	Mehmet Murtezi	Rindërtim	Statusi i Pronësisë (Fleta Poseduse)
5.	Enver Vrella	Rindërtim	Statusi i Pronësisë (Fleta Poseduse)
6.	Rafiz Behluli	Renovim	Certifikatë e Legalizimit
7.	Vjollca Limani	Renovim	Certifikatë e Legalizimit
8.	Hajdar Idrizi	Renovim	Certifikatë e Legalizimit
9.	Fetihe Kryeziu	Renovim	Certifikatë e Legalizimit
10.	Ramiz Jashari	Renovim	Certifikatë e Legalizimit
11.	Ymer Rexhepi	Renovim	Statusi i Pronësisë (Fleta Poseduse)
12.	Shkumbin Haliti	Renovim	Certifikatë e Legalizimit
13.	Hajdin Aliu	Renovim	Statusi i Pronësisë, Legalizimi

3. Lista e të tërhequrve nga aplikimi

Aplikuesit që janë tërhequr nga aplikimi:

Nr.	Emri dhe Mbiemri i aplikuesit të tërhequr nga nën-projekti	Nën-projekti	Komente (nëse ka):
-----	--	--------------	--------------------

1.	Nuk ka raste	Renovim	
2.	Nuk ka raste	Rindërtim	
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			

4. Lista e Aplikuesve të Refuzuar

Aplikuesit që janë refuzuar për shkak të mos-plotësimit të kriterëve bazë për përfitim nga nën-projektet për renovim / rindërtim të shtëpive, kriterë që kanë të bëjnë veçanërisht me dëshminë e statusit social dhe pronësinë:

Nr.	Emri dhe Mbiemri i aplikuesit të refuzuar	Nën-projekti	Komente (nëse ka):
1.	Vlora Zeqiri	Rindërtim	Kërkesa për ndërtim të ri – nënprojekti nuk parasheh ndërtime në parcela të reja, pasi aplikuesi nuk posedon pronë apo shtëpi.
2.	Besa Agushi-Spahi	Renovim	<p>Prona në fjalë është e pabanuar tash e disa dekada dhe aktualisht nuk shfrytëzohet për banim. Familja ka të zgjidhur çështjen e banimit, pasi jeton në banesën e saj në Ferizaj dhe njëkohësisht posedon edhe prona të tjera. Bazuar në gjendjen ekonomike dhe kushtet e banimit, familja nuk hyn në kategorinë e familjeve të cenueshme apo atyre me çështje të pazgjidhur të strehimit.</p> <p>Familja është larguar nga fshati Jezerc për të jetuar në Ferizaj, për shkak të kushteve më të vështira të jetesës në zonën rurale. Si rezultat, banimi i tyre është sistemuar dhe stabilizuar në qytet, ndërsa prona në fshat ka mbetur e pabanuar dhe jashtë funksionit të banimit.</p>

5. Procedura e ankesave

Aplikuesit e pa kënaqur me rezultatet e shpallura, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Ndërtesën e Komunës – Njësiti i Implementimit të Projektit (NjIP) - brenda 15 ditëve nga dita e publikimit të listës së përfituesve.

6. Konfidencialiteti

Komuna e Ferizajit me rastin e shpalljes së këtyre listave respekton në mënyrë strikte rregullat e konfidencialitetit dhe privatësisë së aplikuesve, duke garantuar njëkohësisht edhe transparencë institucionale.

7. Konsiderata Mjedisore dhe Sociale

Në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së aplikuesve, Komuna e Ferizajit është siguruar që implementimi i nën-projekteve, në të gjitha fazat e tij, të jetë në përputhje me legjislacionin relevant të aplikueshëm në Kosovë, si dhe me kërkesat e Kornizës së Menaxhimit Mjedisor e Social të Projektit, të përcaktuara në Manualin e Implementimit të Projektit.

Komuna e Ferizajit, 28/05/2026